



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1404 Prot.

Tiranë, më 06 /10/2021

V E N D I M

Nr. 189 , Datë 06 / 10 /2021

Mbështetur në nenin 32/1/c, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar dhe bazuar në informacionin dhe shqetësimin e ngritur në media nga Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit (në vijim SPPSH), mbi vendosjen e kriterit të moshës 18-30 vjeç, për pranimin e policëve të rinj, në Akademinë e Sigurisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim Komisioneri) filloi procedurat për ndjekjen e çështjes ex-officio.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve.

Rezultoi se, në kronikën e transmetuar në Televizionin Top Channel, në datën 02.10.2020¹: “300 policët e rinj/Sindikata: Kriteri i moshës në shkelje të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi”, përfaqësues të Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit, kanë ngritur shqetësimin se, në konkursin e zhvilluar për pranimin në Shkollën Bazë të Policisë, si patrullë e përgjithshme, një nga kriteret ishte që kandidatët duhet të ishin nga mosha 18 deri në 30 vjeç. Sipas SPPSH, vendosja e moshës 30 vjeç është shkelje e hapur e ligjit dhe Kushtetutës, pasi qytetari i hiqet e drejta që të konkurojë kur është mbi 30 vjeç. Janë testimet fizike ato që tregojnë aftësitë fizike që ka individit për të konkuruar dhe për t’u bërë pjesë e Policisë së Shtetit. Nga mosha 35 vjeç deri në moshën 65 vjeç, është një periudhë shumë e gjatë pune që mund të bëjë një qytetar, i cili konkuron dhe mund të fitojë edhe në moshën 35 vjeç, është shprehur ndër të tjera përfaqësuesi i SPPSH.

Nga verifikimi i kryer nga Komisioneri, ne faqen zyrtare të internetit të Policisë së Shtetit, rezulton se, në datën 16.09.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka hapur aplikimet për të gjithë kandidatët e interesuar për të ndjekur Shkollën Bazë të Policisë për “Patrullë e

¹ <https://top-channel.tv/2020/10/02/300-policet-e-rinj-sindikata-kriteri-i-moshes-ne-shkelje-te-ligjit-per-mbrojtjen-nga-diskriminimi/>

Përgjithshme” dhe ndjekjen e studimeve në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë” për “Patrullë e Përgjithshme”, në Akademinë e Sigurisë, për vitin akademik 2021-2022².

Referuar kritereve të aplikimit, rezulton se aplikanti, për të ndjekur studimet në Shkollën Bazë të Policisë për “Patrullë e Përgjithshme”, ndër të tjera duhet të jetë i moshës deri në 30 vjeç.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e çështjes nga Komisioneri.

Në ushtrim të kompetencës së parashikuar nga neni 33/1/c të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar³, e cila i jep të drejtën Komisionerit që të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji, Komisioneri me urdhrin me urdhrin nr.118, datë 09.10.2020, urdhëroi fillimin e procedurave hetimore për ndjekjen kryesisht të çështjes mbi vendosjen e kriterit të moshës 18-30 vjeç, për pranimin në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë” për “Patrullë e Përgjithshme”, në Akademinë e Sigurisë.

Hapat procedurialë të ndjekur nga Komisionerit për shqyrtimin e çështjes, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1- Me shkresën nr.1377/2 prot., datë 26.10.2020, Komisioneri njoftoi Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*në vijim DPPSH*), për fillimin e procedurave administrative për hetimin dhe kërkoi parashtrime lidhur me pretendimet e ngritura. Ndër të tjera, në mënyrë të veçantë Komisioneri kërkoi informacion lidhur me çështjet e mëposhtme:

- Cila është arsyeja për vendosjen e këtij kriteri në lidhje me moshën për pranimin në Akademinë e Sigurisë, pra cili është qëllimi që synon të arrijë Policia e Shtetit nëpërmjet vendosjes së një kriteri të tillë?
- Ku është bazuar vendimarrja për vendosjen e moshës maksimale 30 vjeç për të konkuruar në Shkollën Bazë të Policisë? Cilat janë arsyet se përse një person me moshë 35 vjeç, nuk mund të jetë i aftë për të kryer detyrën e punonjësit të policisë? Cilat janë arsyet që testimet fizike nuk janë të mjaftueshme për të gjykuar mbi aftësitë fizike të kandidatëve që duan të bëhen pjesë e Policisë së Shtetit?

2. Me shkresën nr.1/688-1 prot., datë 02.11.2020⁴, DPPSH ka dërguar parashtrimet në lidhje me çështjen, duke informuar Komisionerin se:

Pranimi i shtetasve në Kolegjin e Lartë Profesional “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë, bëhet nëpërmjet konkurimit të hapur sipas kritereve të parashikuara në nenin 38, të ligjit

² <https://www.asp.gov.al/si-te-behesh-punonjes-policie-formulari-i-aplikimin-online/>

³ Në datën 18.11.2020, kanë fyre në fuqi ndryshimet ligjore të miratuara me ligjin nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10221, datë 04.02.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”³. Këto ndryshime nuk prekin asnjë aspekt të çështjes objekt shqyrtimi.

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1377/3 prot., datë 04.11.2020.

nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Në pikën 2, të nenit 38, të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar përcaktohet: *“Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasve në institucionin arsimor policor janë si më poshtë: a) të jetë shtetas shqiptar; b) të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit, strukturat e tjera të sigurisë kombetare apo të jetë larguar nga shërbimi civil; c) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën; d) të ketë arsimin e mesëm; dh) të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur; e) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë, të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje; ë) të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B; f) të jetë pajisur me vërtetimin e besueshmërisë; g) të plotësojë standartet dhe kriteret e tjera të veçanta që lidhen me konkurimin, të përcaktuara nga Akademia e Sigurisë dhe të miratuara nga Ministri i Brendshëm”*

Në urdhrin nr.107, datë 25.03.2020 të Ministrit të Brendshëm “Për përcaktimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”, janë përcaktuar kriteret e veçanta për pranimin në Akademinë e Sigurisë. Konkretisht në gërmen “a”, pika 2, të urdhrin nr.107, datë 25.03.2020 të Ministrit të Brendshëm, përcaktohet: *a) Të jetë në moshë jo më shumë se 30 vjeç.*

Në urdhrin nr.629, datë 10.07.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për shpalljen e aplikimeve për konkurim, për pranim në Kolegjin e Lartë Profesional “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë”, në zbatim të urdhrin nr.107, datë 25.03.2020 të Ministrit të Brendshëm, është vendosur kriteri i moshës 18-30 vjeç.

DPPSH, sqaron se, në 5 vitet e fundit, në pranimet që janë bërë në Kolegjin e Lartë Profesional “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë, moshë nuk ka qenë kriter. Kriteri i moshës është vendosur me urdhrin nr.107, datë 25.03.2020 të Ministrit të Brendshëm, pas ndryshimeve të bëra në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” me ligjin nr.112/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit, të ndryshuar”. Ky kriter është zbatuar në procesin e pranimit në Kolegjin e Lartë Profesional “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë, për vitin Akademik 2020-2021.

3. Në lidhje me çështjen pranë Komisionerit ka dërguar informacion edhe SPPSH. Me shkresën nr.37/1 prot., datë 09.11.2020⁵, SPPSH ka informuar ndër të tjera Komisionerin se:

Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, bie në kundërshtim me ligjin nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe shkel Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenin 49, të saj, ku, secili ka të drejtë dhe është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit profesional.

Në pikën 1, të nenit 3 ‘përkufizime’ si dhe gërmat “a” dhe “b” të pikës 1, të nenit 12 “Ndalimi nga diskriminimi”, Kreu II “Mbrojtja nga diskriminimi në punësim”, të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, kriteri i moshës i vendosur, përjashton dhe

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1377/3 prot., datë 04.11.2020.

kufizon të drejtën e individit mbi këtë moshë që të zgjedhë profesionin, vendin e punës edhe pse janë të aftë që t'u përgjigjen kërkesave dhe testeve të pranimit sipas ligjit dhe rregullores së brendshme në fuqi të Policisë së Shtetit (VKM nr.750, datë 16.09.2015)

Një kufizim i tillë duke përjashtuar personat mbi moshën 30 vjeç, parashikuar në aktin administrativ të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nuk gjen asnjë mbështetje si në ligjin nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”* apo edhe në akte të tjera ligjore e nënligjore. Në nenin 38, *“Kriteret për pranimin në Akademinë e Sigurisë”*, të ligjit nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”* në kriteret e renditura për pranimet në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit, nuk parashikohet në asnjë vend kriteri i moshës. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka kompetencë ligjore të nxjerrë vetëm urdhra si akt administrativ (germa “ç”, pika 1 e nenit 9, të ligjit *“Për Policinë e Shtetit”*) në zbatim të ligjit, ku përcakton dhe procedurat standarte të pranimit në përputhje me Kushtetutën, ligjin nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe Rregulloren e Policisë së Shtetit, të miratuar me VKM nr.750, datë 16.09.2015 *“Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit”*.

SPPSH shprehet se, në dijeninë e tyre kriteri i moshës 18-30 vjeç, si kusht i vendosur për t'u pranuar në Shkollën Bazë të Policisë, nuk ka ekzistuar, është vendosur së fundmi dhe Sindikata kërkon ndryshimin e tij në përputhje me ligjin. Sipas SPPSH, është e padrejtë që të ketë kufizime të moshës 18-30 vjeç, pasi ka shumë persona mbi 30 vjeç, të cilët janë më të aftë nga ana shëndetësore dhe fizike se ato në moshën nën 30 vjeç, të mirëpërgatitur fizikisht apo të shkolluar dhe më inteligjent për t'u përballur me testet e vendosura. Ajo që mund të bëjë skualifikimin është vetëm arritja e rezultatit që shpall fituesin sipas sipas kriterëve ligjore. Nuk ka asnjë arsye se përse duhet përjashtuar nga testimi, konkurimi, e pranimi, për personat mbi 30 vjeç. Sipas SPPSH, mund të jenë edhe mbi 30 apo 35 vjeç dhe të kenë kohë dhe aftësi fizike të mjaftueshme dhe inteligjencë e përkushtim në detyrë më të mirë se sa një tjetër nën këtë moshë.

Sipas SPPSH, testet fizike dhe të tjerat, përveç moshës, janë kompetencë ligjore e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, për t'i përfshirë në urdhrat e tij dhe këto janë të përcaktuara më së miri në aktet ligjore në fuqi për profesionin e punonjësit të policisë, janë të plota e të domosdoshme për pranimet në polici. Kjo ka të bëjë me aftësitë individuale, psikologjike, intelektuale dhe kondicionin fizik individual të lartë dhe jo me moshën. Në rast se nuk arrihen testi fizik apo testet e tjera, natyrisht që bëhet skualifikimi i personit konkures. SPPSH shprehet se, e rëndësishme është sidomos testi psikologjik dhe formimi i përgjithshëm, që duhet të shkojnë paralelisht me atë fizik. Në të kundërt në rast se i jepet përparësi anës fizike, do të kemi punonjës policie të mirë fizikisht por me inteligjencë të ulët.

SPPSH, deklaron se, në dijeninë e tyre, në standartet e përdorura nga Bashkimi Europian nuk ekziston një kriter moshe por vetëm teste dhe sipas saj vendosja e këtij kriteri përbën shkelje të të drejtave të njeriut. Aktualisht, me ligj të veçantë e drejta për punë është deri në moshën 65 vjeç për burra dhe 62 për gratë.

Standartet e vendeve anëtare të Sindikatave të Policisë Europiane (CESP-it), janë në përputhje me konventat dhe Kartën Sociale të punonjësve dhe bien ndesh e në kundërshtim me një trajtim të

tillë që i bën Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit në rastin në fjalë, duke shkelur të drejtat e njeriut me kufizimet e vendosura për shkak të moshës.

4. Me shkresën nr.1559 prot., datë 12.11.2020, Komisioneri iu drejtuar Ministrisë së Brendshme, duke e njoftuar për fillimin e procedurave hetimore për shqyrtimin e kësaj çështje si dhe duke kërkuar informacion, në kushtet kur kriteri i moshës 18-30 vjeç rezultoi të jetë përcaktuar me urdhrin nr.107, datë 25.03.2020, *“Për përcaktimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”*, të Ministrit të Punëve të Brendshme. Ministrisë së Brendshme i'u kërkuar që të jepte informacion, ndër të tjera, në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- A është kriteri i moshës 18-30 vjeç, i vendosur me urdhrin nr.107 datë 25.03.2020, Ministrit të Brendshëm, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës, për sa kohë është një kriter që kufizon të drejtën e personave për të ndjekur arsimin dhe më pas për t'u bërë pjesë e Policisë së Shtetit, për shkak të moshës, në kushtet kur nuk rezultojnë të jetë një kriter i vendosur nga Ligji nr. 107/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar?
- Cila është arsyeja për vendosjen e këtij kriteri, pra cili është qëllimi apo interesi legjitim, që synohet të arrihet nëpërmjet vendosjes së një kriteri të tillë?
- Ku është bazuar vendimarrja për vendosjen e moshës maksimale 30 vjeç për të konkuruar në Shkollën Bazë të Policisë? Cilat janë arsyet se përse një person me moshë 35 vjeç, nuk mund të jetë i aftë për të kryer detyrën e punonjësit të policisë? Cilat janë arsyet që testimet fizike nuk janë të mjaftueshme për të gjykuar mbi aftësitë fizike të kandidatëve që duan të bëhen pjesë e Policisë së Shtetit?

Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, me shkresën nr.8246/4 prot., datë 23.12.2020, *Ministria e Brendshme (në vijim MB)*, informoi Komisionerin se:

Bazuar në problematikat e identifikuara nga ana e Policisë së Shtetit, në procesin e rekrutimit të kontigjentëve fillestar, ky kriter konsiderohet shumë i rëndësishëm për një proces të shëndoshë dhe prurje të përshtatshme në Policinë e Shtetit.

Policia e Shtetit në bashkëpunim dhe me Akademinë e Sigurisë i propozuan Ministrit të Brendshëm vendosjen e këtij kriteri, pasi moshat mbi 30 vjeç, të rekrutuara në Policinë e Shtetit në nivelin bazë nuk rezultojnë të përshtatshme për detyrat e këtij niveli, por edhe nuk premttonin për të bërë karriërë në nivelet më të larta të Policisë së Shtetit.

Në bazë të propozimit të ardhur nga Akademia e Sigurisë, Ministri i Brendshëm, në zbatim të nenit 37 dhe 38 të ligjit nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar, me urdhrin nr.107, datë 25.03.2020 *“Për përcaktimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”*, u vendos kriteri i moshës jo më shumë se 30 vjeç.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e diferencues dhe më pak të favorshëm.

Misioni, organizimi, funksionimi, detyrat, të drejtat dhe statusi i Policisë së Shtetit në Republikën e Shqipërisë, rregullohen dhe përcaktohen nga ligji nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar (në vijim Ligji nr.108/2014). Objekt i rregullimit nga ky ligj, janë gjithashtu edhe veprimtaria, marrëdhëniet e punës, garantimi i karrierës, mirëqenies dhe vazhdimësisë në detyrë të punonjësit të policisë. (neni 1, i Ligjit nr.108/2014).

Sipas Ligjit nr.108/2014, punonjës policie, është personi i emëruar në strukturat e Policisë së Shtetit, pas përfundimit të arsimit/kualifikimit përkatës dhe mban gradën policore (neni 6, pika 16), ndërsa pranimi në polici, është marrja e attributeve të punonjësit të policisë me akt të drejtorit të policisë.

Pranimi, formimi dhe ecuria në karrierë në Policinë e Shtetit, parashikohet dhe rregullohet në Kreun IV, të Ligjit nr.108/2014. Në nenin 37/1 “Akademia e Sigurisë”, të këtij ligji, përcaktohet se: “Policia ka institucionin e saj arsimor përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrative dhe menaxherial.” Pika 5, e nenit të sipërcituar, parashikon se: “Organizimi dhe funksionimi i Akademisë së Sigurisë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Me vendimin nr. 185, datë 25.02.2015, Këshilli i Ministrave, ka miratuar mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Akademisë së Sigurisë. Referuar VKM-së së sipërcituar, Akademia e Sigurisë është pjesë përbërëse e strukturës së Policisë së Shtetit dhe organizimi dhe funksionimi i saj bazohet në legjisllacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe për Policinë e Shtetit. Akademia e Sigurisë, ndër të tjera përgjigjet për, formimin bazë të punonjësve të nivelit bazë të Policisë së Shtetit (germa “a”, e pikës 3, të VKM-së nr.185/2015).

Bazuar në nenin 17, pika 7, të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se, një nga llojet e institucioneve të arsimit të lartë është edhe Akademia. Referuar nenit 19, të këtij ligji, Akademia, është institucion i arsimit të lartë i profilizuar, që vepron në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale. Referuar Statutit dhe Rregullores të Akademisë së Sigurisë, Akademia e Sigurisë është institucion publik i arsimit të lartë që synon arsimimin e punonjësve të policisë, që respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për arsimin e lartë dhe ligjin për Policinë e Shtetit.

Bazuar në Rregulloren e Policisë së Shtetit (në vijim Rregullorja e Policisë së Shtetit), e cila është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.750, datë 16.09.2015 dhe konkretisht në nenin 145 “Pranimi në Polici”, përcaktohet se: “Me përfundimin e shkollës bazë të policisë, kursanti pranohet punonjës policie, i jepet grada policore “inspektor” dhe emërohet në detyrë, me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit,” ndërsa në nenin 147/1, të Rregullores së Policisë së

Shtetit, parashikohet: *“Punonjësi i policisë në momentin e pranimit në polici, nënshkruan kontratën individuale të punës midis tij dhe Drejtorit të Policisë së Shtetit”*

Sa më sipër, rezulton se, procedurat e pranimit dhe konkurimit në Akademinë e Sigurisë janë një gërshetim i dy fushave të mbuluara nga ligji nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, fushës së arsimit dhe fushës së punësimit. Nga njëra anë kemi të bëjmë me një institucion të arsimit të lartë, sikurse përcaktohet më sipër statusi i Akademisë së Sigurisë, ndërkohë që nga ana tjetër, pranimi në Policinë e Shtetit dhe marrja e statusit të punonjësit të policisë, realizohet nëpërmjet pranimit në Akademinë e Sigurisë dhe për rrjedhojë, procedurat dhe kriteret e pranimit në Akademinë e Sigurisë, shërbejnë dhe përfaqësojnë kriteret për të patur akses dhe për të krijuar një marrëdhënie punësimi midis personave të interesuar për t’u bërë punonjës policie dhe Policisë së Shtetit.

Sa më sipër dhe duke u nisur nga problematika e ngritur nga SPPSH, e cila konsistonte në faktin që kriteri i moshës i vendosur për pranimin në Akademinë e Sigurisë, çenonte të drejtën e personit për të zgjedhur lirisht profesionin dhe vendin e punës, të parashikuar nga neni 49, i Kushtetutës, Komisioneri vlerësoi se, shqyrtimi i çështjes dhe i pretendimit për diskriminim do të përqëndrohet dhe do të vlerësohet në kuadër të mbrojtjes nga diskriminimi në fushën e punësimit.

Gjatë shqyrtimit të çështjes rezultoi se, me urdhrin nr. 629, datë 10.07.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është urdhëruar shpallja e aplikimeve për konkurim për pranim dhe ndjekjen e studimeve në Kolegjin Profesional të Lartë *“Kolegji i Policisë”* për *“Patrullë të Përgjithshme”*, në Akademinë e Sigurisë për vitin akademik 2020-2021. Në pikën 5, germa *“b”* të këtij urdhëri, ndër kriteret e përgjithshme që duhet të përmbushë aplikanti, është që të ketë mbushur moshën 18 vjeç dhe të jetë nën 30 vjeç. DPPSH, shpjegoi gjatë shqyrtimit të ankesës se, vendosja e kriterit në lidhje me moshën e aplikantëve bazohet në urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 107, datë 25.03.2020 *“Për Përcaktimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”* (në vijim Urdhri nr.107/2020 të Ministrit të Brendshëm). Rezulton nga verifikimi i kryer nga Komisioneri se, i njëjti kriter është vendosur nga DPPSH, në hapjen e procesit të aplikimit edhe për vitin akademik 2021-2022.

Me urdhrin nr. 107/2020 të Ministrit të Brendshëm, në pikën 1, germa *“b”* dhe pikën 2, germa *“a”* është vendosur: *“1.Kriteret e veçanta për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, të jenë si më poshtë:b) të jenë jo më shumë se 30 vjeç;2. Përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 38, pika 2 e ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, kriteret e veçanta për pranimin në Akademinë e Sigurisë, janë si më poshtë:a) Të jenë në moshë jo më shumë se 30 vjeç;...”* Ky urdhër rezulton të ketë dalë në bazë të nenit 37 dhe germës *“g”*, të nenit 38, të ligjit nr.108/2014, i ndryshuar. Duke ju referuar përmbajtjes së këtyre dispozitave ligjore të cilat kanë shërbyer si bazë për miratimin e këtij urdhri, rezulton se:

Në nenin 37 “Akademia e Sigurisë”, të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, parashikohet : “1. “Policia ka institucionin e saj arsimor përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrative dhe menaxherial.”. 2. Akademia e Sigurisë ofron formim, specializime dhe kualifikime për institucione të tjera të zbatimit të ligjit, si dhe për persona fizikë e juridikë në fushën e rendit e të sigurisë publike. 3. Akademia e Sigurisë njihet dhe ekuivalenton diplomat, dëshmitë dhe certifikatat e përfuara në institucionet brenda dhe jashtë vendit në fushën e rendit e të sigurisë, në bazë të marrëveshjeve dhe që nuk mund të njësohen, sipas pikës 4, të këtij neni. 4. Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave për shtetasit që kanë përfunduar studimet jashtë shtetit në fushën e rendit dhe sigurisë publike bëhen sipas legjislacionit për arsimin e lartë. 5. Organizimi dhe funksionimi i Akademisë së Sigurisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Në nenin 38 “Kriteret për pranimin në Akademinë e Sigurisë”, të ligjit nr.108/2014 i ndryshuar, parashikohet : “1. Pranimi në Akademinë e Sigurisë bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur. 2. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasve në institucionin arsimor policor janë si më poshtë: a) të jetë shtetas shqiptar; b) të mos jetë i përjashtuar nga policia e shtetit, strukturat e tjera të sigurisë kombëtare, apo të jetë larguar nga shërbimi civil; c) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën; d) të ketë mbaruar arsimin e mesëm; dh) të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur; e) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë, të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje; ë) të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B; f) të jetë pajisur me vërtetimin e besueshmërisë; g) të plotësojë standartet dhe kriteret e tjera të veçanta që lidhen me konkurimin, të përcaktuara nga Akademia e Sigurisë dhe të miratuara nga Ministri i Brendshëm”

Kolegji Profesional i Lartë “Kolegji i Policisë” për “Patrullë të Përgjithshme”, në Akademinë e Sigurisë, përbën Shkollën Bazë të Policisë.

Për funksione të veçanta në polici, ku kërkohen njohuri specifike të cilat nuk përfitohen në Akademinë e Sigurisë, pranohen nëpërmjet konkurimit, shtetas që plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 40, të ligjit nr.104/2018. Sipas nenit 150, të Rregullores së Policisë së Shtetit, përcaktohet se : “Funksionet e veçanta janë funksionet që kërkojnë njohuri specifike, të cilat nuk përfitohen në Akademinë e Sigurisë dhe plotësojnë nevojat e policisë për specialistë të fushave kompjuterike, ekonomike, juridike, shkencave të natyrës, inxhinierike, të mjedisit, xheniere, të pilotimit, sipas përshkrimeve të punës për çdo funksion të veçantë.” Referuar neneve 151-155, të Rregullores së sipërcituar, parashikohet procedura të tjera dhe të veçanta për konkurimin dhe pranimin të kësaj kategorie punonjësish.

Bazuar në urdhrin nr.107/2020, të Ministrit të Brendshëm, rezulton se kriteri i moshës “jo më shumë se 30 vjeç”, është vendosur për pranimin në Akademinë e Policisë për të dy kategoritë, si për pranimin në Shkollën Bazë të Policisë, pra në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë” për “Patrullë të Përgjithshme”, ashtu edhe për pranimin në polici në funksione të veçanta. Bazuar në udhrin për fillimin kryesisht të procedurave të shqyrtimit çështja në shqyrtim

nga Komisioneri ka si objekt kriterin e moshës “jo më shumë se 30 vjeç”, të vendosur si kriter pranimit në Shkollën Bazë të Policisë për “Patrullë e Përgjithshme”, pra për ndjekjen e Kolegjit Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë” për “Patrullë të Përgjithshme”, në Akademinë e Sigurisë.

E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemimin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie të caktuar për të siguruar mjetet e jetesës. Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të patur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar si një e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. (vendimi nr.20, datë 11.07.2006, i Gjykatës Kushtetuese)

Bazuar në nenin 17/1, të Kushtetutës, përcaktohet se: “1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.” Në vendimin nr. 20, datë 11.07.2006, Gjykata Kushtetuese, ka interpretuar se, në mënyrë se si është formuluar neni 17, i Kushtetutës, nuk i ka dhënë mundësi delegimi ndonjë organi tjetër përveç Kuvendit. Shprehja “vetëm me ligj” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në diskrecion vetëm të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera. Më tej Gjykata Kushtetuese në këtë vendim, ka vijuar me sqarimin se, konteksti në të cilin është përdorur togfjalëshi “vetëm me ligj” nuk lejon të bëhet interpretim i zgjeruar. Kjo edhe për faktin se një interpretim i tillë i normave kushtetuese mund të bëhet vetëm në aspektin pozitiv, kur ky interpretim shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe jo e kundërta.

Duke iu rikthyer çështjes objekt shqyrtimi dhe bazuar në standartin e mësipërm të vendosur nga Gjykata Kushtetuese, Komisioneri vlerëson se, vendosja e kriterit “jo më shumë se 30 vjeç”, për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë për të gjithë ata shtetas që duan të bëhen punonjës police dhe të jenë pjesë e Policisë së Shtetit, sipas pikës 2 (a), të Urdhrit nr.107/2020, të Ministrit të Brendshëm vendos kufizim dhe cënon të drejtën për punë dhe profesion të sanksionuar nga neni 49/1, i Kushtetutës. Kriteri thelbësor i vendosur nga neni 17, i Kushtetutës, ai i kufizimit të të drejtave dhe lirive vetëm me ligj, në çështjen objekt shqyrtimi nuk është respektuar, pasi kufizimi nuk është vendosur me ligj, por me një akt nënligjor, që në rastin konkret është Urdhri nr.107/2020, i Ministrit të Brendshëm.

Komisioneri gjithashtu vlerëson se, germa “g”, e nenit 38, të ligjit nr.108/2014, nuk e ka autorizuar Ministrin e Brendshëm, që të vendosë kriteret e tjera të përgjithshme nga ato të përcaktuara nga vetë kjo dispozitë e ligjit, por të plotësojë standartet dhe kriteret e tjera të veçanta që lidhen me konkurimin. Vendosja e kriterit në lidhje me moshën “jo më shumë se 30 vjeç”, nuk ka të bëjë me standartet dhe nuk mund të konsiderohet një kriter i veçantë që lidhet me konkurimin. Sipas rregullimit që i bëhet mënyrës së pranimit në Akademinë e Sigurisë, parashikuar në Rregulloren e Policisë së Shtetit, nenet 126-144, aplikantët duhet fillimisht të kalojnë fazën e vlerësimit të dokumentacionit dhe plotësimin të kriterëve të përgjithshme të

vendosura nga neni 38, i ligjit nr. 108/2014 dhe më pas kalojnë në fazën e konkurimit ata aplikantë që janë vlerësuar se përmbushin këto kritere. Ndërkohë që kriteri i moshës, i vendosur nga pika 2 (a), e Urdhrit nr.107/2020, të Ministrit të Brendshëm ka vendosur një kriter të përgjithshëm, që është një atribut vetëm i ligjit dhe nuk ka vendosur kritere që lidhen me konkurimin, që është një fazë e mëvonshme e procesit të pranimit në Akademinë e Sigurisë.

Bazuar në nenin 4/1, të ligjit nr.108/2014, përcaktohet se : “1. Policia e Shtetit është institucion i administratës shtetërore, person juridik në varësi administrative të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike.”

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në Kreun II, të ligjit nr.10221 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji, në nenin 12/1/a/b⁶, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në moshë, duke përcaktuar shprehimisht se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;”

Duke vendosur si kriter se, personat mbi moshën 30 vjeç nuk mund të aplikojnë për t’u bërë punonjës policie dhe pjesë e policisë së shtetit, Komisioneri arrin në përfundimin se, kriteri i vendosur nga germa”a”, e pikës 2, të Urdhrit nr. 107/2020, të Ministrit të Brendshëm, prek kriteret e përzgjedhjes dhe rekrutimit për këtë kategori punonjësish, të cilët i përkasin sektorit publik.

Aplikantët të cilët janë mbi 30 vjeç janë në një situatë të ngjashme me atë të aplikantëve më të rinj të cilët janë jo më shumë se 30 vjeç, të cilët marrin pjesë në të njëjtat procedura për pranimit dhe konkurimin në Akademinë e Sigurisë për t’u bërë punonjës të policisë. Aplikantët të cilët janë mbi moshën 30 vjeç, nuk pranohen në konkurim, duke u skualifikuar që në fazën e verifikimit të dokumentacionit, duke u trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, për shkak të moshës, në raport me kategorinë e aplikantë të cilët janë jo më shumë se 30 vjeç.

⁶ Neni 12/1/c, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;”

Komisioneri vlerëson se, në çështjen objekt shqyrtimi, pika 2 (a), e Urdhrit nr. 107/2020, të Ministrit të Brendshëm, sjell si pasojë që persona të caktuar të trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se sa persona të tjerë të gjendur në një situatë të ngjashme, vetëm për shkak se ata janë “*më shumë se 30 vjeç*”. Rrjedhimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, ky kriter/rregullim, trajton në mënyrë të diferencuar, duke vendosur në kushte më pak të favorshme personat të cilët janë “*më shumë se 30 vjeç*” në raport me personat të cilët janë “*jo më shumë se 30 vjeç*”.

B. Shkaku i mbrojtur.

Neni 1, i ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, i cili përcakton objektin e këtij ligji, shprehet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke përfshirë në mënyrë të drejtëpërdrejtë moshën, sipas këtij përcaktimi : “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”

Mosha, si një shkak i mbrojtur, ka të bëjë me trajtimin ose gëzimin në mënyrë të diferencuar, bazuar në moshën e personit ose grupit të personave që janë cënuar nga sjellja diskriminuese.

Megjithëse jo shprehimisht e përfshirë në listën e shkaqeve të mbrojtura nga neni 14, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), mosha, është përfshirë nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) në interpretimin e shkaqeve “të tjera” sipas nenit 14 (GjEDNj, *Schëizgebel kundër Zvicrës, Nr. 25762/07, 10 qershor 2010*).

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit në nenin 3, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Sa më sipër, Komisioneri ka arritur në përfundimin se kriteri “*jo më shumë se 30 vjeç*”, i vendosur si kriter për të aplikuar në Shkollën Bazë të Policisë/ Kolegjin Profesional të Lartë “*Kolegji i Policisë*” për “*Patrullë të Përgjithshme*”, në Akademinë e Sigurisë, e për rrjedhje për t’u bërë punonjës policie, i përcaktuar në pikën 2 (a), të Urdhrit nr. 107/2020, të Ministrit të Brendshëm, trajton në mënyrë të diferencuar, duke vendosur në kushte më pak të favorshme personat të cilët janë “*më shumë se 30 vjeç*” në raport me personat të cilët janë “*jo më shumë se 30 vjeç*”. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, qartazi, një

kriter/rregullim i tillë, përbën një diferencë në trajtim që bazohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek mosha.

C. Lidhja e trajtimit të diferencues dhe më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të të Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga GJEDNJ-ja si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, *“E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”*.

E drejta për punë dhe mbrojtje nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejtë parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*Karta Sociale Evropiane*⁷ në nenin 1, pika 2, parashikon: *“ Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht... ”* Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim⁸. Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Evropiane, ku parashikohet mbrojtje bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh.

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*⁹, sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. E drejta për punë e garantuar në këtë nen përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës duke punuar punën e pranuar lirisht dhe vendos detyrimin për të garantuar dhe për ta mbrojtur këtë të drejtë¹⁰. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar në një listë joshteruese shkaqesh. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Komentin e Përgjithshëm Nr.20, *“Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”*, miratuar në 02 korrik 2009, ka

⁷ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

⁸ Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituaniës*, prg 30.

⁹ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

¹⁰ Komenti i Përgjithshëm Nr.8, Komiteti për të Drejtat Sociale Ekonomike dhe Kulturore, paragrafi 4.

interpretuar se, mosha, përfshihet në shkaqet e mbrojtura sipas nenit 2/2 të Paktit, në kuadër të parashikimit “çdo status tjetër”.

*Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës*¹¹ “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Sipas përcaktimeve të Konventës termi diskriminim përfshin: - çdo dallim, përjashtim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, fenë, opinionin politik, prejardhjen kombëtare, ose origjinën sociale, që ka për efekt të prishë ose shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e punësimit ose të profesionit; - çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose të profesionit.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin. E në fakt mosdiskriminimi dhe parimi i barazisë janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.¹²

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në bazë të ligjit nr.10221/2010“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim konsiderohet diskriminim duke parashikuar në nenin 6, të tij, se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përliqur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

¹¹ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

¹² Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

C.1 Nëse diferenca në trajtim bazohej në një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Në çështjet e diskriminimit, barra e provës është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ku parashikohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”. Në të njëjtën linjë me këtë parashikim në ligjin e posaçëm shkon edhe rregullimi i përgjithshëm që bën Kodi i Procedurave Administrative në nenin 82/2, ku përcaktohet se : “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹³

Në kushtet, kur, Komisioneri ka arritur në përfundimin se, kriteri/rregullimi i përcaktuar në pikën 2 (a), të Urdhrit nr. 107/2020, të Ministrisë të Brendshme, përbën një diferencë në trajtim që bazohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek mosha, mbetet që të vlerësohet nëse kjo diferencë në trajtim mund të justifikohet. Siç është theksuar edhe më sipër, një justifikim i tillë duhet të jetë objektiv dhe i arsyeshëm ose, me fjalë të tjera, ai duhet të ndjekë një qëllim të ligjshëm dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet. Në këto kushte dhe bazuar në barrën e provës për çështjet e diskriminimit, i takon Ministrisë së Brendshme, në cilësinë e autoritetit që ka miratuar Urdhrit nr. 107/2020, të tregojë që kjo diferencë në trajtim mund të justifikohet.

¹³

https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodë Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Sikurse rezultoi, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në Urdhrin nr. 629/2020, pika 5 (a), ka vendosur kriterin e moshës “jo më shumë se 30 vjeç”, pjesë të kriterëve të përgjithshme, që duhet të përmbushin aplikantët që janë të interesuar për tu pranuar në Akademinë e Sigurisë, duke u bazuar në Urdhrin nr. 107/2020, të Ministrit të Brendshëm. Për këtë arsye, Komisioneri përfshiu si palë në këtë procedurë administrivë Ministrinë e Brendshme.

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Ministria e Brendshme, nuk i parashtrroi Komisionerit, se cili ishte qëllimi legjitim i synuar të arrihej nëpërmjet vendosjes së kriterit për pranimin në Akademinë e Sigurisë të kontigjentëve fillestarë për në Policinë e Shtetit, të shtetasve të cilët janë jo më shumë se 30 vjeç. Në përgjigjen e dërguar nga Ministria e Brendshme, kjo e fundit parashtrroi se, ky kriter konsiderohet shumë i rëndësishëm, për një proces të shëndoshë dhe prurje të përshtatshme në Policinë e Shtetit. Ministria e Brendshme parashtrroi se, Policia e Shtetit në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë, i propozuan Ministrit të Brendshëm vendosjen e këtij kriteri, pasi moshat mbi 30 vjeç, të rekrutuara në Policinë e Shtetit, në nivelin bazë, nuk rezultojnë të përshtatshme për detyrat e këtij niveli dhe se nuk premtorin për të bërë karrierë, në nivelet më të larta të Policisë së Shtetit.

Në mënyrë të veçantë, neni 6, pika 2, e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon se, trajtimi i ndryshëm që bazohet në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji, ndër të tjera moshë, nuk përbën diskriminim kur për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj. Si pasojë, diferencat në trajtim mbi bazën e moshës mund lejohen në rrethana të caktuara. Në këto raste, kufizimet që kanë si shkak moshën, duhet të vlerësohet rast pas rasti dhe një vlerësim i tillë duhet të marrë parasysh të gjitha faktet dhe provat përkatëse, përfshirë natyrën e detyrave, të personave të përfshirë.

Sa më sipër, rezultojnë se, nuk është shkak i mbrojtur mbi të cilin bazohet diferenca në trajtim, por është karakteristika që lidhet me atë shkak, e cila duhet të përbëjë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme. Ministria e Brendshme nuk shpjegoi se, cila është ajo karakteristikë, e cila për shkak të natyrës apo kushteve në të cilat ushtrohet veprimtaria e punonjësve të rolit bazë apo të kontigjentit fillestar në Policinë e Shtetit. Ministria nuk ofroi asnjë shpjegim se ku konsistonte papërshtatshmëria e personave mbi moshën 30 vjeç, për të kryer detyrat e nivelit bazë. Ministria gjithashtu nuk ofroi asnjë shpjegim se mbi çfarë bazash kishte arritur në përfundimin se përse personat mbi moshën 30 vjeç, dhe jo mbi këtë limit moshe, nuk premtorin për të bërë karrierë në nivelet më të larta.

Komisioneri vlerëson se, Ministria e Brendshme nuk identifikoi asnjë karakteristikë, e cila mund të lidhet me moshën, si një nga shkaqet e mbrojtura, për të vlerësuar më pas nëse kjo karakteristikë përbën ose jo një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme; nëse qëllimi i trajtimit të diferencues ishte i përligjur dhe nëse kjo kërkesë ishte proporcionale në raport me qëllimin që synohet të arrihet.

Bazuar në shpjegimet e Ministrisë së Brendshme, rezulton se, kriteri i vendosur në lidhje me moshën jo më shumë se 30 vjeç, është vendosur me qëllim *garantimin e një procesi të shëndoshë dhe prurje të përshtatshme në Policinë e Shetit*. Ministria e Brendshme, gjithashtu, shpjegoi se, arsytet e vendosjes së kriterit në lidhje me moshën e aplikantëve jo më shumë se 30 vjeç, ishin dy; *së pari*, personat mbi këtë moshë *nuk rezultojnë të përshtatshëm për detyrat e këtij niveli dhe së dyti*, këta persona *nuk premtë për të bërë karrierë, në nivelet më të larta të Policisë së Shtetit*.

Në bazë të arsyetimit të mësipërm, Komisioneri ka arritur në përfundimin se, vendosja e një kufizimi të tillë në lidhje me moshën duhet të ishte përcaktuar me ligj, në respektim të nenit 17, të Kushtetutës, për sa kohë vendos kufizimin e një të drejte kushtetuese, siç është ajo e të drejtës për punë dhe profesion parashikuar nga neni 49, i Kushtetutës; dhe se autorizimi ligjor për Ministrinë e Brendshme, parashikuar në germën “f”, të nenit 38, të ligjit nr.108/2014, i ndryshuar, nuk i jep të drejtën këtij autoriteti, për vendosjen e një kriteri si mosha, i cili është një kriter i përgjithshëm. Ligji, autorizon Ministrinë e Brendshme të plotësojë standartet dhe kriteret e tjera të veçanta që lidhen me konkurimin. Këto aspekte, që mund të rregullohen nga ky autoritet, nuk korrespondojnë me vendosjen e një kriteri të tillë si mosha, për rrjedhojë Ministri i Brendshëm, ka vendosur kriterin në lidhje me moshën, në mungesë të kompetencës.

Megjithatë, pavarësisht kontaktimit të mësipërm, Komisioneri do të vlerësojë edhe në lidhje me ligjshmërinë e qëllimit të synuar nëpërmjet vendosjes së një kriteri të tillë dhe në rast të identifikimit të një qëllimi të tillë do të vlerësojë nëse mjetet e përdorura janë proporcionale me qëllimin e synuar.

Garantimi i karrierës, është pjesë e objektit të ligjit nr. 108/2014, të ndryshuar, sanksionuar në nenin 1, të ligjit, ndërsa, ecuria në karrierë, sipas nenit 6, pika 2, të ligjit, përfshin të gjitha fazat e karrierës që nga emërimi në detyrë i punonjësit të policisë deri në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Parime të tilla si, mosdiskriminimi, integriteti, merita dhe profesionalizmi si dhe transparenca, përbëjnë disa nga parimet bazë që udhëheqin veprimtarinë e Policisë së Shtetit, përcaktuar në nenin 5, të ligjit.

Neni 38/1, i ligjit nr.108/2014, të ndryshuar, parashikon: “ *Pranimi në Akademinë e Sigurisë bëhet nëpërmjet konkurimit të hapur*”, ndërsa në pikën 2, të dispozitës së mësipërme, përmbajtja e të cilës pasqyrohet më sipër, përcaktohen kriteret e përgjithshme të pranimit, ku mosha nuk është një kriter i përcaktuar nga ligji. Rregulla të hollësishme në lidhje me ecurinë në karrierë dhe procesin e pranimit në Akademinë e Sigurisë përcaktohen në Rregulloren e Policisë së Shtetit. Sipas nenit 125/3, të kësaj rregullore, përcaktohet se: “ *3. Politikat e ecurisë në karrierë të përcaktuara në këtë rregullore garantojnë: a) transparencë, përgjegjshmëri e profesionalizëm në procesin e rekrutimeve, për të ofruar në Policinë e Shtetit, shtetas me cilësi të larta morale, integritet e kurajë qytetare, për t'i vënë ato në shërbim të komunitetit; b) promovimin e punonjësve me rezultate të larta, me integritet moral e profesional, duke u ofruar atyre shanse për ngritje në detyrë dhe gradë, brenda fushës së shërbimit; c) zhvillimin e karrierës brenda fushës së shërbimit të punonjësve, për të siguruar ekspertë me cilësi dhe aftësi të veçanta; ç)*

trajnimin profesional të vazhdueshëm, për t'u siguruar që të gjithë punonjësit, kanë dhe ruajnë aftësitë e duhura, për përmbushjen e detyrave.”

Në nenin 126, të Rregullores së Policisë së Shtetit, përcaktohet se: *“1. Pranimi në Akademinë e Sigurisë bazohet në parimin e shanseve të barabarta, meritës, mosdiskriminimit dhe kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës të drejtë, të paanshëm dhe transparent. 2. Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e aftësive të të shkruarit, shprehurit, punës në grup, të aftësive komunikuese, psikologjike, fizike e shëndetësore, të garancive dhe sigurisë së kandidatit.”*

Në nenin 135/1, të Rregullores së Policisë së Shtetit, ku parashikohen fazat e konkurimit, përcaktohet se: *“ 1. Aplikanti që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimit në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet fazave të konkurrimit sipas rendit të mëposhtëm: a) testimin me shkrim; b) testimin të aftësive fizike; c) intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimin të aftësive të të shkruarit; ç) testimin psikologjik; d) kontrollin shëndetësor; dh) marrjes së shenjave të gishtave; e) verifikimi përfundimtar i aplikantit”.*

Komisioneri vlerëson se, qëllimi i synuar nga ana e Ministrisë së Brendshme, për të garantuar një proces të shëndoshë dhe prurje të përshtatshme, përbën një qëllim të ligjshëm, pasi dispozitat e mësipërme, tregojnë qartë për rëndësinë e procesit të pranimit në Akademinë e Sigurisë. Megjithatë, bazuar në faktet dhe informacionin e administruar në lidhje me çështjen, si dhe rregullimin që i bëhet procesit të pranimit në Akademinë e Sigurisë nga Ligji nr.108/2014, i ndryshuar dhe Rregullorja e Policisë së Shtetit, Komisioneri, vlerëson se Ministria e Brendshme nuk vuri në dispozicion asnjë provë nëpërmjet të cilës të tregojë se limiti i moshës i vendosur si kriter për të aplikuar në Akademinë e Sigurisë është një masë e nevojshme dhe e përshtatshme, për të arritur qëllimin e synuar atë të garantimit të një procesi të shëndoshë dhe prurje të përshtatshme.

Komisioneri arrin në këtë përfundim, pasi arsyeja që deklaroi Ministria e Brendshme, për vendosjen e kriterit të moshës jo më shumë se 30 vjeç, në lidhje me *papërshtatshmërinë e personave mbi 30 vjeç për kryerjen e detyrave të këtij niveli*, pa asnjë specifikim në lidhje me faktin se për çfarë aspektesh bëhet fjalë (pamjaftueshmëri fizike, mendore, shëndetësore apo intelektuale), nuk përlligj karakterin që duhet të ketë masa për të qenë e nevojshme dhe e përshtatshme, për arritjen e qëllimit të deklaruar. Për më tepër, Ministria e Brendshme nuk ofroi asnjë informacion apo shpjegim se përse, fazat e konkurimit dhe testimet e parashikuara nga neni 135/1, i Rregullores së Policisë së Shtetit, por edhe procedurat standarte të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për pranimin në Akademinë e Sigurisë, sipas urdhrit nr. 984, datë 17.12.2015, nuk sigurojnë rekrutimin dhe pranimin e aplikantëve të cilët janë të përshtatshëm për kryerjen e detyrave për këtë nivel detyrash. Bazuar në fazat e konkurimit nëpër të cilat kalojnë aplikantët që duan të pranohen në Akademinë e Sigurisë, rezulton se aplikanti i nënshtrohet një sërë testimesh, për të vlerësuar përshtatshmërinë e tij.

Në lidhje me pretendimin tjetër të paraqitur nga Ministria e Brendshme, se personat mbi 30 vjeç, nuk premtajnë për të bërë karrierë në nivelet më të larta të policisë, Komisioneri vlerëson se, një pretendim i tillë është i paqartë, pasi nuk jepet asnjë arsye se përse personat mbi mbi këtë moshë nuk premtajnë për të bërë karrierë. Shkolla Bazë e Policisë për “Patrullë e Përgjithshme”, e cila formon punonjës të rolit bazë, që është edhe objekt shqyrtimi në këtë çështje, rezulton të ketë një kohëzgjatje totale 11 mujore, në përfundim të të cilës, pasi kursantët përfundojnë me sukses shkollimin, emërohen si punonjës policie. Pas emërimit si punonjës policie, fillon edhe marrëdhënia e punësimit dhe fillon ecuria në karrierë. Nëse mungesa e premisë vjen si pasojë e kohës që i duhet punonjësit për t’u formuar si punonjës policie në Shkollën Bazë dhe më pas për të ndjekur hapat dhe fazat e karrierës, në raport me moshën e daljes në pension, që për punonjësit e policisë në vitin 2020 është, 65 vjeç për burrat dhe për 61 vjeç për gratë¹⁴, atëherë Ministria e Brendshme, nuk dha asnjë shpjegim në lidhje me pretendimin se përse personat mbi moshën 30 vjeç, nuk premtajnë për karrierë. Nga ana tjetër, Ministria e Brendshme nuk identifikoi asnjë arsye tjetër, që sipas saj, justifikon pretendimin se personat mbi 30 vjeç nuk premtajnë për të bërë karrierë në nivelet më të larta. Për më tepër, ecuria në karrierë deri në nivelet më të larta, nuk mund të përbëjë një qëllim në vetvete, pasi jo të gjithë personat që bëhen pjesë e Policisë së Shtetit mund të kenë aspiratë për të arritur nivelet më të larta brenda kësaj organizatë. Por, ashtu sikurse përcaktohet në Rregulloren e Policisë së Shtetit, politikat e ecurisë në karrierë duhet të garantojnë mbi baza të barabarta dhe bazuar në meritë, mundësinë e ecurisë në karrierë për të gjithë ata persona që mund të jenë të ineteresuar dhe jo që të gjithë punonjësit që bëhen pjesë e Policisë së Shtetit t’u garantohet arritja e niveleve më të larta drejtuese.

Në këto kushte, Komisioneri vlerësoi që kryesisht të kryente një hulumtim mbi praktikën gjyqësore të GjEDNj-së dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian (*në vijim GjDBE*) në lidhje me rastet e trajtuara nga ana e këtyre gjykatave, në lidhje me shkeljen e parimit të barazisë në lidhje me moshën. Nga hulumtimi i realizuar Komisioneri vlerësoi të marrë në referencë çështjet C-258/2015, *Gorka Salaberria Sorondo v. Academia Vasca de Policía y Emergencias*, 15 nëntor 2016 dhe C- 416/13, *Mario Vital Pérez v. Ayuntamiento de Oviedo*, 13 nëntor 2014, të GjDBE.

Në çështjen *Mario Vital Pérez kundër Ayuntamiento de Oviedo*, GjDBE, u pyet nëse një kufi moshe prej 30 vjetësh për rekrutimin e një oficeri policie vendore shkelte parimin e trajtimit të barabartë për shkak të moshës dhe rrjedhimisht përbënte diskriminim. GjDBE, riafirmoi se "zotërimi i aftësive të veçanta fizike është një karakteristikë në lidhje me moshën". GjDBE gjithashtu deklaroi se, *qëllimi për të siguruar kapacitetin operacional dhe funksionimin e duhur të shërbimit policor*, përbën një objektiv legjitim brenda kuptimit të direktivës. Sidoqoftë, GjDBE hodhi poshtë argumentet e Shtetit Anëtar se, në këtë rast kufiri i moshës ishte i nevojshëm për të arritur qëllimin e tij. Testet fizike eliminatorë do të ishin një masë e mjaftueshme me të cilat mund të vlerësohej nëse kandidatët posedojnë nivelin e veçantë të aftësisë fizike të kërkuar për

¹⁴ Në vijim moshë e daljes në pension rritet në mënyrë progresive sipas parashikimeve të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar deri në barazimin e moshës për pension midis burrave dhe grave në moshën 67 vjeç në vitin 2056.

kryerjen e detyrave të tyre profesionale. Gjykata, gjithashtu argumentoi se, as kërkesat për trajnim të postit dhe as nevoja për të siguruar një periudhë të arsyeshme punësimi para daljes në pension nuk mund të justifikonin kufirin e moshës.

Në çështjen, *Gorka Salaberría Sorondo kundër Academia Vasca de Policía y Emergencias*, duke vendosur kufirin e moshës në 35 vjet për rekrutimin si oficer policie në Shtetin Bask nuk konsiderohej se përbënte trajtim diskriminues. GjDBE e dalloj këtë rast nga çështja *Mario Vital Pérez kundër Ayuntamiento de Oviedo*, duke u mbështetur në faktet e mëposhtme:

- detyrat e vendosura ndaj punonjësve ishin fizikisht kërkuese;
- u konsiderua se një oficer policie, i cili është mbi 55 vjeç, nuk ishte më në zotërim të plotë të aftësive të nevojshme për kryerjen e duhur të detyrave të tij;
- rekrutimi i një kandidati më të vjetër se 35 vjet nuk do të siguronte kohë të mjaftueshme që ai person të caktohej në detyrat e tij profesionale, të cilat janë fizikisht kërkuese, për një periudhë mjaftueshërisht të gjatë.

Për arritjen e përfundimeve të mësipërme, GjDBE u mbështet në të dhënat statistikore të paraqitura gjatë shqyrtimit të çështjes, të cilat treguan se si do të zhvillohej piramida e moshës në vitet në vijim. Të dhënat zbuluan se ishte e nevojshme të rivendoset një strukturë e veçantë moshe për të pasur një numër të mjaftueshëm punonjës policie, të cilëve mund t'u caktoheshin detyrat më të vështira fizikisht. Kjo do të ishte e mundur duke zëvendësuar gradualisht punonjësit e policisë më të vjetër, përmes rekrutimit të stafit më të ri, më të pajisur për të marrë detyra fizikisht të vështira.

Referuar çështjeve të mësipërme të trajtuara nga GjDBE dhe fakteve dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit të çështjes konkrete, Komisioneri konstaton se:

Ministria e Brendshme edhe pse parashtron se, personat mbi 30 vjeç, nuk janë të përshtatshëm për detyrat e këtij niveli, nuk shpjegon se ku konsiston papërshtatshmëria e tyre dhe nëse papërshtatshmëria lidhet me aspektin e aftësive fizike apo është e natyrave të tjera, në lidhje me psikologjinë apo me aspekte të inteligjencës. Ministria e Brendshme nuk ofroi asnjë shpjegim se si personat me moshë mbi 30 vjeç, nuk premtinin për karrierë.

Nga ana e Ministrisë së Brendshme nuk u pretendua se papërshtatshmëria e aplikantëve mbi moshën 30 vjeç kishte të bënte me faktin e ata nuk zotërojnë kapacitetin e duhur fizik për ushtrimin e detyrave. Ministria e Brendshme, pretendoi vetëm se, aplikantët mbi këtë moshë kishin rezultuar të papërshtatshëm për kryerjen e detyrave të nivelit bazë që është “Patrulla e Përgjithshme”. Nga informacioni i Ministrisë së Brendshme, por edhe informacioni i përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke qenë se bazuar në propozimin e kësaj të fundit Ministria e Brendshme ka miratuar kriterin në lidhje me moshën, nuk rezulton se për cilat arsye personat mbi 30 vjeç janë të papërshtatshëm për kryerjen e detyrave të këtij niveli, Pra, çfarë natyre kanë detyrat që do të ushtrohen nga punonjësit e policisë së këtij niveli dhe për cilat arsye ato nuk mund të përmbushen nga personat mbi moshën 30 vjeç, duke shtuar këtu se nuk u

ofrua asnjë shpjegim se përse testimet që kryhen gjatë konkurimit janë të pamjaftueshme për të vlerësuar në lidhje me përshtatshmërinë e aplikantëve me moshë mbi 30 vjeç.

Ecuria në karrierë në nivelet më të larta në Policinë e Shtetit nuk mund të shërbejë si një qëllim i ligjshëm në vetvete. Megjithatë, edhe nëse qëllimi do të ishte që të sigurohej një periudhë e arsyeshme punësimi përpara daljes në pension, deri në arritjen e kësaj moshe, që për punonjësit e policisë aktualisht është 65 për burrat dhe 61 për gratë, Komisioneri vlerëson se, përcaktimi i moshës maksimale për rekrutimin e punonjësit të policisë, jo më shumë se 30 vjeç, nuk mund të justifikohet, pasi deri në mbushjen e moshës për pension ka një kohë të konsiderueshme që personi mund të punojë. Komisioneri arrin në përfundimin se, Ministria e Brendshme nuk paraqiti asnjë provë që të vërtetonte, se mosha limit e vendosur, është e përshtatshme dhe e nevojshme, për të arritur qëllimin e synuar atë të garantimit të karrierës, jo domosdoshmërisht në nivelet e larta apo të garantimit të një periudhe të arsyeshme punësimi përpara daljes në pension.

Nga ana tjetër, Ministria e Brendshme nuk pretendoi dhe as nuk rezultoi nga informacioni i vendosur në dispozicion të Komisionerit, se rekrutimi i personave jo më shumë se 30 vjeç, mund të kishte si qëllim për të siguruar kapacitetin operacional dhe funksionimin e duhur të shërbimit policor, qëllim ky i cili është konsideruar nga GjDBE si një objektiv legjitim.

Pasja e aftësive apo e një kapaciteti të caktuar fizik, është një karakteristikë e lidhur me moshën, sikurse është konstatuar nga praktika e mësipërme, tashmë e konsoliduar edhe në raste të tjera nga GjDBE, në lidhje me kufizimin e moshës së daljes në pension të pilotëve (*çështja C-447/09, Prigge dhe të tjerë kundër Deutsche Lufthansa AG, 13 shtator 2011*) apo në lidhje me vendosjen e moshës limit jo më shumë se 30 vjeç për rekrutimin e punonjësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit (*çështja C-229/08, Wolf kundër Stadt Frankfurt am Main, 12 janar 2010*).

Ministria e Brendshme nuk pretendoi se vendosja e kriterit të moshës jo më shumë se 30 vjeç ishte vendosur për shkak se për kryerjen e detyrave nga ana e punonjësve të policisë së nivelit bazë kërkohen aftësi fizike të veçanta. Kryesisht Komisioneri vlerësoi, detyrat e përcaktuara nga ligji nr.108/2014, i ndryshuar për punonjësit e policisë, të përcaktuara në nenin 17/1, të këtij ligji. Sipas kësaj dispozite : *“Detyrat e Policisë së Shtetit janë: a) mbron jetën, shëndetin, pronën publike dhe private; b) ruan rendin dhe sigurinë publike; c) parandalon, zbulon dhe heton, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre; ç) organizon fushata ndërgjegjësuese dhe informuese, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale, si dhe rritjen e bashkëpunimit me publikun; d) koordinon punën me inspektoratet kompetente në fushën e ndërtimit, kontrollit të mjedisit dhe territorit, për marrjen e sanksioneve administrative dhe sanksioneve të tjera, sipas ligjit të tyre funksional; dh) identifikon, siguron dhe trajton në ambientet e saj, personat e arrestuar ose të ndaluar deri në caktimin e masës së sigurimit me vendim gjykate, si dhe të dënuarve me vendim të formës së prerë në mungesë, deri në transferimin e tyre në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale; e) mbikëqyr dhe drejton trafikun rrugor në rrugë për përdorim publik, në përputhje me legjislacionin rrugor; ë) mbikëqyr dhe kontrollon kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë; f) kontrollon regjimin e hyrje-daljeve të të huajve, të qëndrimit, të punësimit e të trajtimit të tyre në*

Republikën e Shqipërisë; g) identifikon, mbron dhe referon për asistencë, pranë autoriteteve përkatëse, viktimat e trafikimit, të personave dhe dhunës në familje, veçanërisht të miturit dhe gratë; gj) administron dhe mbron informacionin e klasifikuar, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në legjislacion; i) merr, trajton dhe/ose referon pranë strukturave përgjegjëse, ankesat e shtetasve, në mënyrë të veçantë kallëzimet penale ose informacionet e dhëna në rrugë të ndryshme për vepra penale, si dhe kryen detyra të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi;”

Disa nga këto detyra, si mbrojtja e jetës, shëndetit, pronës publike dhe private apo mbrojtja e rendit dhe sigurisë publike, mund të kërkojnë pasjen e një niveli të caktuar të kapacitetit fizik apo aftësi fizike në caktuar, me qëllim kryerjen e detyrave që policisë së shtetit i ngakohen nga ligji. Rrjedhimisht pasja e një niveli të caktuar aftësish fizike për kryerjen e detyrave të punonjësit të policisë së shtetit mund të konsiderohet një kërkesë e vërtetë dhe profesionale e domosdoshme, në kuptim të nenit 6/1 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, me qëllim ushtrimin e këtij profesioni. Por, sipas të njëjtës dispozitë, duhet që, kjo kërkesë, të jetë e përligjur dhe të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj. Nga informacioni i administruar nuk rezultoi asnjë e dhënë që të tregonte se përse personat mbi 30 vjeç nuk posedojnë këto aftësi të nevojshme fizike, që mund të nevojiten për ushtrimin e detyrave të këtij niveli dhe se si diferenca në trajtim e vendosur, nëpërmjet përcaktimit të një moshe maksimale për rekrutimin e punonjësve të policisë të nivelit bazë, është e përshtatshme dhe e domosdoshme për arritjen e qëllimit.

Zbatimi i parimit të barazisë, në rastin konkret në lidhje me moshën, nuk kërkon rekrutimin ose mbajtjen në punë, të personave që nuk janë të përshtatshëm për kryerjen e detyrave. Megjithatë, për sa kohë që trajtimi i ndryshëm i përligjur, ndër të tjera në lidhje me moshën, përbën një shmangie nga ky parim, atëherë edhe justifikimi ose përligja e trajtimit të ndryshëm, duhet të interpretohet ngushtësisht. Bazuar në provat dhe informacionin e administruar, nuk rezultoi e provuar se ku konsiston papërshtatshmëria e personave që janë më shumë se 30 vjeç, që duan të bëhen punonjës policie, në raport me ata që synojnë të njejtnë gjë, por që janë jo më shumë se 30 vjeç.

Në këto kushte, Ministria e Brendshme, nuk arriti të provojë se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin më pak të favorshëm të personave të cilët janë mbi 30 vjeç në raport me personat jo më shumë se 30 vjeç, gjatë procesit të pranimit dhe konkurimit në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë” për “Patrullë të Përgjithshme”, në Akademinë e Sigurisë, që përbën Shkollën Bazë të Policisë.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, kriteri/rregullimi, që bëhet nga pika 2 (a), e Urdhrit nr. 107/2020, të Ministrit të Brendshëm, trajton në mënyrë të diferencuar, duke vendosur në kushte më pak të favorshme personat të cilët janë “më shumë se 30 vjeç” në raport me personat të cilët janë “jo më shumë se 30 vjeç” dhe se një trajtim i tillë nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Për rrjedhojë, Komisioneri konstaton se, kriteri/rregullimi që bëhet nga pika 2 (a), e Urdhrit nr. 107/2020, të Ministrit të Brendshëm, diskriminon për shkak të

moshës kategorinë e personave mbi 30 vjeç, për të gëzuar akses të barabartë në punësim dhe profesion.

Përfundimi i mësipërm shkon në linjë me vendimarrjet e mëparshme të Komisionerit, ku është konstatuar se kriteri i moshës, i përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr.600, datë 09.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe kriterëve për oficerët e sigurisë”, ka karakter diskriminues për shkak të moshës, pasi nuk u provua që vendosja e këtij kriteri ndiqte një qëllim të ligjshëm dhe të justifikuar objektivisht. (Vendimi i Komisionerit Nr.43, datë 19.03.2019, M.K kundër Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë)

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat e diskriminimit. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës, është marrja e masave nga ana e Ministrisë së Brendshme për të rishikuar Urdhrin nr. 107/2020, me qëllim heqjen e kriterit diskriminues në lidhje me moshën, që duhet të plotësojnë personat që duan të aplikojnë për pranimin në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë” për “Patrullë të Përgjithshme”, në Akademinë e Sigurisë.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të kategorisë së personave “mbi 30 vjeç” për shkak të moshës, për të gëzuar akses të barabartë në punësim dhe profesion, përmes zbatimit të pikës 2 (a), të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm Nr. 107, datë 25.03.2020 “Për

Përcaktimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”.

2. Ministria e Brendshme, të marri masa për rishikimin e Urdhrit Nr. 107, datë 25.03.2020 “*Për Përcaktimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë shtetasit që aplikojnë për pranimin në Akademinë e Sigurisë”*, duke hequr kriterin kufizues në lidhje me moshën e personave që aplikojnë për pranim në Akademinë e Sigurisë, të vendosur në pikën 2 (a) të urdhrin të sipërcituar.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Ministria e Brendshme, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Konc: Klodiana Keta, Inspektore DHA
Rishikoi: Rudina Hoxha, Inspektore DHA
Miratoi: Vilfrida Bushati, Drejtore DHA
Datë: 27.09.2021